



nr. \_\_\_\_\_

**MARRËVESHJE**  
**për llogari të transaksionit në valutë të huaj për person juridik – rezident**

E lidhur në Shkup, më datë \_\_\_\_\_, midis:

1. Komercijalna banka AD Skopje (në tekstin e mëposhtëm: Banka), e përfaqësuar nga \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_ (në tekstin e mëposhtëm: Posedues i llogarisë) dhe \_\_\_\_\_ përfaqësuar nga \_\_\_\_\_.

**Nr. i llogarisë** \_\_\_\_\_

**Dispozitat e përgjithshme**

**Neni 1**

Me këtë Marrëveshje rregullohen të drejtat e ndërsjella, detyrimet dhe përgjegjësitë ndërmjet palëve, që dalin nga hapja, udhëheqja, puna dhe mbyllja e llogarisë së transaksionit në valutë të huaj të personave rezident – subjekt juridik, për shkak të realizimit të qarkullimit pagesor ndërkombëtar, përkatësisht pagesa me rezident dhe jorezident në deviza, nëpërmjet instrumenteve të zakonshme të qarkullimit pagesor ndërkombëtar (remitenca, dokumente inkaso, akreditiva, çeqe dhe instrumente të tjera të pagesave me të holla të gatshme), transferim të mjeteve nga/në depozita në valutë, si dhe pagesa në para të huaja efektive, në pajtim me rregullat ligjore dhe nënligjore.

**Neni 2**

Shërbimet lidhur me hapjen, udhëheqjen, punën dhe mbylljen e llogarisë së transaksionit, Banka i kryen në përputhje me këtë Marrëveshje, Kushtet e përgjithshme për hapjen dhe punën me llogaritë e transaksionit në valutë të personave juridik – rezident të Komercijalna Banka AD Skopje (në tekstin e mëposhtëm: Kushtet e përgjithshme), rregullave ligjore dhe nënligjore, aktet e politikës afariste të Bankës dhe dokumenteve të tjera që janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

**Hapja e llogarisë**

**Neni 3**

Në bazë të kësaj Marrëveshje, Banka hap llogari të transaksionit në valutë të Poseduesit të llogarisë, nëpërmjet së cilës Poseduesi i llogarisë do të realizojë të hyra nga jo rezidentë, pagesa jorezidentëve dhe aktivitete tjera të qarkullimit pagesor me jashtë në përputhje me rregullat ligjore dhe nënligjore.

#### **Neni 4**

Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshje, Poseduesi i llogarisë vërteton se i është dhënë një kopje dhe se tërësisht e pranon dhe është i njohur me përmbajtjen e dokumentacionit më vijim:

- Kushtet e përgjithshme për hapjen dhe punën me llogaritë e transaksionit në valutë të huaj të personave juridik- rezidentë të Komercijalna Banka AD Skopje,
- fragment nga Vendimi për tarifrat e kompensimeve dhe shërbimeve që i kryen Banka, në të cilën janë theksuar të gjitha shpenzimet, provizionet dhe kompensimet të lidhura me punën e llogarisë,
- fragment nga Vendimi për normat e interesit të Bankës, me të cilën caktohet lartësia e normës së interesit që paguhet në llogarinë e transaksionit të personave juridikë, dhe
- dokumentet tjera, të cilët e rregullojnë punën me llogarinë.

Dokumentacioni i plotë i cituar në alinenë 1 të këtij neni paraqet pjesë përbërëse të kësaj Marrëveshje.

#### **Neni 5**

Poseduesi i llogarisë dhe Banka obligohen se gjatë kryerjes së qarkullimit pagesor me botën e jashtme do t'i respektojë rregullat ligjore dhe nënligjore në fuqi, Kushtet e përgjithshme, Marrëveshjen dhe aktet e tjera dhe dokumentet me të cilat rregullohet qarkullimi pagesor me jashtë dhe mënyrën e hapjes, udhëheqjes dhe mbylljes së llogarisë.

#### **Neni 6**

Poseduesit të llogarisë, Banka i jep kartonë për nënshkrim, me të cilat Poseduesi i llogarisë cakton Persona të autorizuar, të cilët do të disponojnë me mjetet nga llogaria. Për shkak të mbrojtjes së interesave të tij, Poseduesi i llogarisë është i detyruar me kujdes t'i ruajë dhe ti përdorë kartonët e nënshkruar.

Banka nuk mban asnjë përgjegjësi për ndonjë dëm material apo çfarëdo lloji tjetër të dëmtimit që mund të paraqitet si rezultat i ruajtjes dhe përdorimit të pakujdesshëm dhe të papërgjegjshëm të kartonëve të nënshkrimit.

#### **Neni 7**

Poseduesi i llogarisë obligohet që për çdo ndryshim të personave të autorizuar, ose të tregëtarëve themelore të personit juridik-rezident, menjëherë ose në afat prej tre ditëve, ta njoftojë Bankën. Për dëmin eventual të ndodhur për shkak të njoftimit jo në kohë nga ana e Poseduesit të llogarisë, Banka nuk mban asnjë përgjegjësi.

Për shkak të nevojës së përditësimit të dokumentacionit në Bankë, Poseduesi i llogarisë është i detyruar më së paku njëherë në pesë vjet t'i paraqesë Bankës dokumentacion adekuat për identifikim në pajtim me rregullat ligjore dhe nënligjore dhe aktet e Bankës, nëse kjo nuk është rregulluar ndryshe me aktet e brendshme të Bankës.

### **Mënyra e realizimit të qarkullimit pagesor me jashtë**

### **Neni 8**

Poseduesi i llogarisë është i obliguar të dërgojë urdhëresa të plotësuara në mënyrë të rregullt dhe të saktë për realizimin e qarkullimit pagesor me jashtë. Banka nuk merr asnjë përgjegjësi për dëmin eventual që mund të dalë për Poseduesin e llogarisë për shkak të gabimeve gjatë plotësimit të urdhëresave.

Banka e njofton Poseduesin e llogarisë për urdhëresat e plotësuara gabimisht dhe të pa kompletuara për realizim të qarkullimit pagesor me jashtë të cilat nuk do të realizohen.

Banka e realizon urdhëresën të njëjtën ditë ose ditën e punës në vazhdim, nëse urdhëresa është plotësuar siç duhet, është e kompletuar me dokumentacionin e nevojshëm dhe për realizimin e saj ka mjete të disponueshme në llogarinë.

Banka e rezervon të drejtën të kërkojë dokumentacion plotësues gjatë realizimit të urdhëresave, në pajtim me standardet ndërkombëtare, praktikën ndërkombëtare, rregullat ligjore dhe nënligjore dhe aktet e brendshme.

Për realizimin e urdhëresës ose pagesës Banka dorëzon njoftim deri te Poseduesi i llogarisë, në mënyrë dhe afat të përcaktuar dhe kontraktuar në mënyrë të ndërsjellë.

### **Neni 9**

Poseduesi i llogarisë me autorizim të veçantë me shkrim mundet ta autorizojë Bankën në emër dhe për llogari të tij realizojë pagesa jashtë vendit dhe ta caktojë orarin e pagesave të arritura, përkatësisht t'i mposhë dhe plotësojë instrumentet për realizimin e qarkullimit pagesor në bazë të të dhënave me shkrim të dërguara në mënyrë të rregullt ose dokumentacionit të kërkuar në përputhje me rregullat ligjore dhe nënligjore.

### **Përlllogaritja e interesit**

#### **Neni 10**

Mjetet e llogarisë janë mjete në të parë me të cilat Poseduesi i llogarisë mund të disponojë në çdo kohë.

Mjeteve në llogari Banka u llogarit dhe paguan normë interesi në përputhje me Vendimin për normat e interesit në fuqi të Bankës në ditën e llogaritjes. Norma e interesit e llogaritur shkruhet në gjendjen e llogarisë.

#### **Neni 11**

Poseduesi i llogarisë mund të dorëzojë kërkesë me shkrim deri te Banka për afatizimin e mjeteve të llogarisë së tij për periudhë të caktuar kohore dhe normë interesi, në përputhje me Vendimin për normat e interesit të Bankës. Për afatizimin e mjeteve lidhet Marrëveshje e veçantë ndërmjet Bankës dhe Poseduesit të llogarisë, ku nga më afër rregullohen marrëdhëniet e ndërsjella të palëve, që janë si rezultat i afatizimit të mjeteve.

#### **Neni 12**

Nëse nga ana e organit kompetent të autorizuar për mjetet e evidentuara në llogari është shqiptuar masë ndëshkuese e përkohshme ngrirje, konfiskim, ndalim të realizimit të transaksioneve, ndalesë posedimi dhe ngjashëm, sa i përket normave të

interesit zbatohen rregulla të veçanta nëpërmjet Vendimit për normat e interesit të Bankës.

## **Pagesa e kompensimit**

### **Neni 13**

Për realizimin e shërbimeve lidhur me qarkullimin pagesor me jashtë dhe punën me llogarinë, Banka faturon kompensim për lartësinë, afatet sipas mënyrës së përcaktuar në Vendimin në fuqi për tarifimin e kompensimeve për shërbimet që i bën Banka në ditën e realizimit.

### **Neni 14**

Për të gjitha shpenzimet e lidhura me qarkullimin pagesor me jashtë dhe të gjitha kërkesat e Bankës, të cilat mund të ndodhin gjatë punës me llogarinë, Poseduesi i saj e autorizon Bankën, pa pajtimin e tij paraprak, të krijojë urdhëresë dhe ta ngarkojë llogarinë e tij të transaksionit në denarë.

Nëse në llogarinë e transaksionit në denarë nuk ka mjete të mjaftueshme, Poseduesi i llogarisë pajtohet që pagesa e provizioneve, kompensimeve dhe shpenzimeve të cituara në nenin paraprak, të realizohet nga llogaria e transaksionit në valutë të huaj e hapur në përputhje me këtë Marrëveshje. Poseduesi i llogarisë e autorizon Bankën dhe i jep urdhëresë të pakthyeshme në emër të tij dhe për llogarinë e tij t'i merr dhe zbatojë të gjitha aktivitetet dhe veprimet e duhura, si dhe ta nënshkruajë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për pagesën e provizioneve, kompensimeve dhe shpenzimeve.

Shitblerja e mjeteve valutore me urdhëresë të Poseduesit të llogarisë kryhet sipas çmimit të kontraktuar të kursit blerës ose shitës në momentin e realizimit të transaksionit.

Banka, për provizionet, kompensimet dhe shpenzimet e maturuara, llogarit dhe paguan normë interesi ndëshkuese, në pajtim me dispozitat ligjore dhe Vendimin për normat e interesit të Bankës.

Poseduesi i llogarisë realizon inspektim të të gjitha borxheve të llogarisë dhe pagesave, që kanë për bazë provizionet, kompensimet dhe shpenzimet, të cilat i paguan Banka, nëpërmjet inspektimit të ndryshimeve në Raportin e llogarisë.

Mbi bazën e kërkesës me shkrim të Poseduesit të llogarisë, Banka do t'i dorëzojë listë të provizioneve, kompensimeve dhe shpenzimeve të përlllogaritura për një periudhë të caktuar.

## **Njoftime**

### **Neni 15**

Poseduesi i llogarisë obligohet ta njoftojë Bankën për të gjitha ndryshimet e statusit, ndryshimet e nënshkruesve të autorizuar, të dhënat e adresës dhe të gjitha informacionet tjera, që i ka dhënë gjatë lidhjes së kësaj Marrëveshjeje, menjëherë ose më së voni në afat prej tri ditësh nga realizimi i ndryshimit.

Poseduesi i llogarisë e merr tërë përgjegjësinë për të gjitha pasojat, që mund të ndodhin si rezultat i mos njoftimit në kohë të ndryshimeve relevante.

#### **Neni 16**

Për gjendjen dhe ndryshimet e ndodhura në llogari, Banka e njofton Poseduesin e llogarisë me dorëzimin e Raportit të ndryshimeve dhe gjendjen e llogarisë, në mënyrën e përcaktuar dhe të kontraktuar me Poseduesin e llogarisë.

Me dorëzimin ose marrjen e raportit, Poseduesi i llogarisë konsiderohet se është i njoftuar me të gjitha ndryshimet si në llogarinë e tij ashtu edhe me punën e Bankës.

#### **Neni 17**

Poseduesi i llogarisë është i detyruar ta kontrollojë saktësinë e raportit dhe nëse vëren parregullsi, në afat prej tetë ditësh nga marrja e raportit të dorëzojë parashtrësë deri te Banka. Banka përgjigjet lidhur me parashtrësën në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të parashtrësës.

#### **Neni 18**

Banka e mban të drejtën të bëjë ndryshime në vëllimin dhe përmbajtjen e llojeve të caktuara të shërbimeve dhe kushteve të bashkëpunimit afarist të rregulluara me Kushtet e përgjithshme, Marrëveshjen, Vendimin për tarifën dhe kompensimeve për shërbimet që i bën Banka, Vendimin për normat e interesit, aktet e politikës afariste të Bankës dhe dokumenteve të tjera, të cilët e rregullojnë punën me llogarinë dhe për këtë e njofton Poseduesin e llogarisë nëpërmjet publikimit të informatës në raportin e llogarisë së tij, ose ueb faqen e Bankës.

#### **Neni 19**

Palët e kontraktuara pajtohen se e rregullt do të konsiderohet dërgesa e realizuar në adresën e fundit të lajmëruar nga Poseduesi i llogarisë në Bankë.

#### **Neni 20**

Nëse Poseduesi i llogarisë nuk pajtohet me ndryshime të caktuara në punën e llogarisë mund të paraqesë vërejtje me shkrim ose kërkesë për ndërprerjen e Marrëveshjes brenda 15 ditëve pas përfundimit të muajit në të cilin informacioni është publikuar, ndryshe konsiderohet se ai pajtohet me ndryshimet e propozuara dhe të njëjta bëhen pjesë përbërëse të kësaj Marrëveshjeje.

### **Mbrojtja e të dhënave**

#### **Neni 21**

Banka në pajtueshmëri me rregullat ligjore në fuqi obligohet të sigurojë diskrecion dhe do t'i mbrojë të dhënat e punës me llogarinë. Të dhënat për punën e llogarisë mund t'i dërgohen vetëm Poseduesit të llogarisë, organit të autorizuar në përputhje me ligjin, ose personave të tretë në bazë të pajtueshmërisë së dhënë nga ana e Poseduesit të llogarisë.

#### **Neni 22**

Të dyja palët obligohen se në fshehtësi do t'i ruajnë të gjitha të dhënat dhe informatat për të cilat kanë fituar njohuri në lidhje me realizimin e kësaj Marrëveshje, për kohëzgjatjen e Marrëveshjes, si dhe pas prishjes ose anulimit të saj, përveç asaj që është përshkruar me rregullat në fuqi ose nuk merren vesh qartë në mënyrë tjetër.

### **Neni 23**

Për shkak të mbrojtjes së interesave të tij, Poseduesi i llogarisë është i obliguar që me besueshmëri të rreptë t'i mbrojë dhe ruajë të gjitha të dhënat që lidhen me punën e llogarisë, duke përfshirë edhe numrin dhe gjendjen e llogarisë, kartonët nënshkruar, nënshkruarit e autorizuar, mënyrën e disponimit me mjetet dhe të ngjashme. Poseduesi i llogarisë është i detyruar ta kufizojë qasjen në informatat e lartpërmendura vetëm për personat, që është e nevojshme t'i dinë informacionet e besueshme, si dhe t'i njoftojë me detyrimet e mara me këtë Marrëveshje të gjitha personat, të cilët në çfarëdo mënyre janë të lidhur me punën me llogarinë.

Banka nuk përgjigjet për çdo lloj dëmi, që mund ti ndodh Poseduesit të llogarisë si rezultat i mosrespektimit të detyrimeve nga paragrafi paraprak.

### **Neni 24**

Banka do të ndërmarrë dhe do të sigurojë masat e nevojshme për mbrojtje të të dhënave personale të personave të autorizuar në përputhje me rregullat ligjore. Të dhënat personale të subjekteve do të përdoren vetëm për nevojat e punës me llogarinë, në bazë të pajtueshmërisë së subjekteve të të dhënave personale dhe në raste dhe mënyrën e paraparë me ligj ose nën ndonjë rregullore tjetër.

## **Vlefshmëria dhe ndërprerja e Marrëveshjes**

### **Neni 25**

Kjo Marrëveshje lidhet për periudhë të pacaktuar kohore. Secila nga palët e kontraktuara mund ta prishë Marrëveshjen nëpërmjet njoftimit me shkrim dërguar deri te pala tjetër me afat anulimi prej 30 ditëve dhe pas plotësimit paraprak të të gjitha obligimeve që dalin nga kjo Marrëveshje.

Banka ka të drejtë në mënyrë të njëanshme ta prishë Marrëveshjen edhe pa afat anulimi, nëse Poseduesi i llogarisë sillet në kundërshtim me dispozitat e kësaj Marrëveshje dhe Kushtet e përgjithshme, ose në kundërshtim me rregullat ligjore dhe nënligjore.

Në rast të prishjes së Marrëveshjes, ose mbylljes së llogarisë në pajtim me rregullat ligjore dhe nënligjore, ose aktet e brendshme të Bankës, Banka do t'i transferojë mjetet nga llogaria në llogari tjetër, në përputhje me instruksionet e dhëna nga Poseduesi i llogarisë. Nëse Poseduesi i llogarisë nuk ka dhënë instruksione se në cilën llogari të transferohen mjetet, Banka do t'i transferojë dhe do t'i ruajë mjetet në llogari të veçantë qëllimore deri në marrjen e instruksioneve nga ana e Poseduesit për transfer në llogari tjetër.

## **Dispozitat tjera**

## Neni 26

Banka nuk përgjigjet për ndërprerjen e shërbimeve lidhur me realizimin e qarkullimit pagesor me botën e jashtme dhe pasojat nga ndërprerja, që është jashtë kontrollit të Bankës, përkatësisht që është pasojë e fuqisë madhore dhe rrethanave, të cilat nuk është mundur të parashikohen, pengohen, mënjanojnë ose shmangen.

Banka nuk merr përgjegjësi për dëmin, shpenzimet ose humbjen, për çfarëdolloj zvogëlimi të vlerës ose detyrimi të çfarëdollojtë, që është si rrjedhojë e veprimit, përkatësisht mosveprimit të Bankës, në pajtim me ose që lidhet me ndërprerjen në sistemet e pagesës.

Banka nuk merr detyrim për mbrojtjen e mjeteve të llogarisë në rast të likuidimit, procedurës së përmbarimit, sigurimit me ndonjë masë paraprake ose të përkohshme, ose ndonjë procedure të ngjashme mbi Poseduesin e llogarisë në pajtim me rregullat ligjore dhe nënligjore.

## Neni 27

Nëse ndodhin ndryshime në rregullat ligjore që e rregullojnë punën me llogarinë dhe qarkullimin pagesor me jashtë, Banka do t'i zbatojë ligjet dhe dispozitat e reja, të cilat do të hyjnë në fuqi në kohën e vlefshmërisë së kësaj Marrëveshjeje. Nëse ndryshimet e tilla nuk janë adekuate me interesat afariste të Poseduesit të llogarisë, ai ka të drejtë ta prishë Marrëveshjen në afat prej 15 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të ndryshimeve.

## Neni 28

Termet në këtë Marrëveshje janë përdorur enkas dhe me qëllim të kuptimit më të mirë të saj dhe nuk do të zbatohen dhe interpretohen në interpelancën ose shfrytëzimin e kësaj Marrëveshjeje.

## Neni 29

Për gjithçka që nuk është paraparë në këtë Marrëveshje vlejné dispozitat ligjore dhe aktet e politikës afariste të Bankës.

## Neni 30

Në rast të kontesit, kompetente është Gjykata e Shkupit.

## Neni 31

Marrëveshja është përpiluar në dy kopje identike, nga një për secilën palë.

## Neni 32

Marrëveshja është lidhur dhe hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga të dy palët.

**POSEDUESI I LLOGARISË**

**KOMERCIJALNA BANKA AD  
SKOPJE**

---

(nënshkrimi dhe vula e personit  
autorizues për përfaqësim)